

PKR.nr.345/14

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** gjykata e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, Suzana Çerkini me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit L.Sh. nga P., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.1048/2013, të datës 20.06.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 23.03.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Abdurrahim Islami dhe të akuzuarit L. Sh., të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari L.Sh.,** nga i ati Sh. dhe nëna G., e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin M. Komuna P., tani me vendbanim në P., banon me qira, ka të kryer shkollën e mesme, bashkëpronar në firmën ndërtimore “K. I.”, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ RKS *numer personal...*,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse, me datë 06.10.2013, rreth orës 24:00h, pas mesnate, patrulla policore në afërsi të “Rrethi i spitalit”, në Prishtinë, pasi kanë ndaluar veturën e markës “Golf V”, ngjyrë hiri me targa *numeri i targave...*, pronë e të pandehurit L., gjatë kontrollimit të veturës së tij, në dollapin e përparëm ia kanë gjetë dhe sekuestruar një sprej të tipit “American Style Nato Superparalisant”, të cilin e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 46, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe nenit 248, 365 dhe 366 të KPP, i shqipton,

## **DËNIM ME GJOBË**

Në shumë prej **350 € (treqindpesëdhjetë euro)**, të cilin dënim obligohet t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet komfor nenit 46 të KPRK, gjykata këtë dënim me gjobë do t'ia shëndrrojë në dënim me burg duke llogaritur 20 euro për një ditë burgim.

## **DËNIM PLOTËSUES**

Konfiskohet: një sprej American Style NATO, Super Paralisant, ngjyrë e gjelbërt, i precizuar në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve Nr.2013-AD-3994, të datës 06.10.2013, si mjet i kryerjes së veprës penale.

I akuzuari obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP.I.nr. 1048/2013, të datës 18.06.2014, ka akuzuar L.Sh. nga P., për shkak të veprës penale Mbjajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administritimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarin t'a shpall fajtor, t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 23.03.2016, në të cilën i pandehuri, i vënë në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë, për çka i njëjti deklaroi se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe nuk ka kryer asnjëherë më parë një vepër të tillë apo të ngjashme.

Prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë nga i akuzuari, meqë ky pranim është në përputhje me dispozitat e KPP.

Pas deklarimit të të pandehurit, se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet dhe, pajtimin për pranimin e fajësisë së të pandehurit nga prokurori i shtetit, gjykata gjithashtu e aprovoi fajësinë nga i pandehuri, pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të pandehurit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmbanë akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri, është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe, i shqiptoi dënim të paraparë ligjor, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit të lartshënuar, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur, premtimin e dhënë se nuk do t'a përsërisë veprën penale, paraqitjen korrekte dhe të sinqertë në gjykatë, faktin se nuk zhvillohet procedurë penale për asnjë vepër tjetër penale ndaj të njëjtit, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj në aplikim të dispozitave të zbutjes së dënimit, të njëjtit i shqiptoi dënim me gjobë, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se i akuzuari në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendit, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK lidhur me nenin 374 par.5 të KPK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.345/14, me datë 23.03.2016**

**Sekretarja juridike  
Ardita Azemi**

---

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.